REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr 305 Prot Maliq, më 22.1.2026

PROJEKT VENDIM - NR.11

Për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor në pronësi të Bashkisë Maliq.

Bazuar në :
Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen vendore* "i ndryshuar; Ligj nr. 57/2020 "*Për pyjet*"; Ligji nr.9693 datë 19.03.2007 "Për fondin Kullosor" i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 433 datë 8.6.2016 "*Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike...*", i ndryshuar; Urdhrit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 299 datë 04.10.2022 "*Për miratimin e planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore të Bashkia Maliq*"; Udhëzimi nr. 1, datë 09.06.2016 i Ministrit të Mjedisit "*Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik*"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 559 datë 29.07.2022 "*Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor*"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.467 datë 31.07.2025 "*Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme*";

I propozoj Këshillit të Bashkisë:

1. Miratimin për dhënien në përdorim të sipërfaqes prej 20 m² në ngastrën nr. 39c të Ekonomisë Pyjore Moglicë, Fshati Gurshqipe, Njësia Administrative Moglicë, Bashkia Maliq, me qëllim ngritjen e një Antene Telefonike nga kompania Vodafone Albania sh.a.
2. Ngarkohet Sektori i Pyjeve dhe Kullotave për fillimin e procedurave për hartimin e raportit tekniko-ekonomik për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor me sipërfaqe 20 m² me objekt ngritjen e Antenës Telefonike.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi Bashkia Maliq nxjerr certifikatat e pronësisë të ngastrave që do jepen në përdorim dhe lidh kontratën e qirasë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar.

Konceptoi P.Theodhosi Dt.22/01/2026
K.Brako Dt.22/01/2026
R.Murataj Dt.22/01/2026

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
SEKTORI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

Maliq më.22/01/2026

RELACION

Për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor në pronësi të Bashkisë Maliq.

Të nderuar Këshilltarë të Bashkisë Maliq.
Nisur nga kërkesa e subjektit Hellas Servis shpk nënkontraktor i subjektit Vodafone Albania me nr. 636 prot datë 12.01.2026, protokolluar pranë Bashkisë Maliq me nr. 174 prot datë 14.01.2026, ku kërkohet dhënia në përdorim e fondit pyjor/kullosor në pronësi të Bashkisë Maliq për ngritjen e një Antene Telefonike të subjektit Vodafone Albania sh.a, në zbatim të ligjit 57/2020 "Për Pyjet", ligjit nr.9693 datë 19.03.2007 "Për fondin Kullosor" i ndryshuar, dhe udhëzimit nr. 1 pika 22 e në vazhdim "për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor", Bashkisë Maliq i lind e drejta ligjore për përdorimin e fondit pyjor/kullosor në pronësi të saj për ta dhënë në përdorim për të zhvilluar aktivitete ekonomike në fushën e komunikimit radioteleviziv dhe telefonisë celulare.

1. Hyrje.

Vendosja e një antene të telefonisë celulare në këtë zonë ku mbulimi me valë ka qenë vazhdimisht problematik për banorët e zonës sjell një përmirësim të shërbimit në përfitim të komunitetit që jeton në këto zona.

2. Relacion

Ashtu siç e ka përmendur edhe subjekti në kërkesën e tij, shoqëria Vodafone në përmbushje të detyrimeve të saj për mbulimin me valë të telefonisë celulare dhe ofrimin e një shërbimi sa më cilësor, kërkon të instalojë një antenë celulare pranë fshatit Gurshqipe Njësia Administrative Moglicë të Bashkisë Maliq.

Kompania Vodafone ka përzgjedhur këtë sipërfaqe pasi plotëson kërkesat teknike të saj për instalimin e antenës brenda kësaj sipërfaqe për të cilën do të vijojë procedurat e mëtejshme për lidhjen e kontratës së qirasë dhe më pas marrjen e lejeve përkatëse siç parashikon legjislacioni shqiptar në fuqi.

Në bazë të plan-vendosjes së dërguar bashkëngjitur kërkesës ku janë pasqyruar koordinatat 40.42.43.22N 20.30.56.52E, kjo sipërfaqe ndodhet në ngastrën 39c të Ekonomisë Pyjore Moglicë.

Konceptoi	P.Theodhosi		Dt.22/01/2026
	K.Brako		Dt.22/01/2026
	R.Murataj		Dt.22/01/2026

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

6th Klm of National Road Tirana - Durres, Kashar, Tirana - Albania
Tel: +35544503717, Fax: +35544503714
Email: hellasservice-al@hellasconstructions.com

BASHKIA MA
Zyra e Protokollit
Nr. 174 Prot.
Date 14.1.26
Nënshkrimi

Datë: 12/01/2026
Prot. Nr. 2636

Drejtuar: Bashkia Maliq

Në vëmendje të: Z. Gëzim Topçiu, Kryetar

Lënda: Kërkesë për instalim antene celulare në territorin e Bashkisë Maliq

Të nderuar Zotërinj,

Kompania Hellas Servis sh.p.k, në kuadrin e bashkëpunimit me Shoqërinë Vodafone Albania sh.a dhe në cilësinë e shoqërisë nën-kontraktore të saj, ndjek proçedurat lidhur me investigimin e zonave për ndërtimin e antenave celulare.

Në vijim të këtij proçesi dëshirojmë t'ju informojmë se shoqëria Vodafone në përmbushje të detyrimeve së saj, për mbulimin me valë të telefonisë celulare dhe ofrimin e një shërbimi sa më cilësor, kërkon të instalojë/vendosë një antenë celulare pranë fshatit Gurshqipe, të Bashkisë Maliq.

Aktualisht, Vodafone ka përzgjedhur një sipërfaqe që plotëson kërkesat teknike të saj për instalimin e antenës brenda kësaj sipërfaqeje, për të cilën do të vijojë proçedurat e mëtejshme për lidhjen e kontratës së qirasë, me pronarin/administratorin ligjor të saj për ndërtimin e stacionit dhe më pas marrjen e lejeve përkatëse, siç parashikon legjislacioni shqiptar në fuqi.

Për sa më lart, duke qenë se sipërfaqja për të cilën interesohemi ndodhet në territorin e Bashkisë Maliq, po ju drejtohemi me këtë Shkresë/Kërkesë për pasurinë me të dhëna si më poshtë, një sipërfaqe prej **20(njëzetë) m2:**

Zona Kadastrale:1911
Numri i Pasurisë: 137
Adresa e Pasurisë: Gurshqipe, Maliq
Koordinatat: 40°42'43.22"N
20°30'56.52"E

6th Klm of National Road Tirana - Durres, Kashar, Tirana - Albania
Tel: +35544503717, Fax: +35544503714
Email: hellasservice-al@hellasconstructions.com

Bashkëngjitur kësaj shkrese gjeni:

- Plan Rilevimi, datë 24.08.2023, përgatitur nga A.SH Engineering shpk
- Ekstrakt i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit " Vodafone Albania" sha
- Licensa për ushtrimin e aktivitetit të Vodafone Albania sha

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj, mbetemi në pritje të miratimit të Kërkesë sonë, për të vijuar me procedurat të mëtejshme.

Me respekt,

Elion Mehmetaj
Menaxher i Departamentit të Implementimit të Rrjetit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT " SHOQËRI AKSIONARE"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	K11715005L			
2. Data e Regjistrimit	15/05/2001			
3. Emri i Subjektit	VODAFONE ALBANIA			
4. Forma ligjore	Shoqëri Aksionare			
5. Data e themelimit	10/05/2001			
6. Kohëzgjatja	Nga: 10/05/2001 Deri:			
7. Zyra qëndrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Kashar KASHAR Autostrada Tirane- Durres, Rruga Pavaresia, Nr.61, Kashar			
8. Kapitali	5.689.874.341,000			
9. Vlera e kapitalit të shlyer:	5689874341.0000			
10. Numri i aksioneve:	437.400,000			
10.1 Vlera nominale:	13.008,400			
11. Kategoritë e aksioneve të shoqërisë	të zakonshme	me përparësi	me të drejte vote	pa të drejte vote
11.1 Numri për secilën kategori				
12. Objekti i aktivitetit:	Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte sigurimi i sherbimeve ne fushen e komunikimeve elektronike dhe ofrimi i sherbimeve te medias audio dhe/ose audiovizuale. Objekti i Shoqerise perfshin gjithashtu: a. Themelimin dhe funksionimin e sistemeve radio			

	telefonike celulare te levizshme GSM dhe fikse te teknologjive te ndryshme dhe kerkimi, projekti, vendosja dhe funksionimi i sistemeve te komunikimeve elektronike, perfshire rrjetet e internetit ("Sistemet"); b. Furnizimi i dhe/ose tregtimi me pajisje, materiale dhe te ngjashme, te perdorura ne lidhje me Sistemet; c. Vendosja dhe funksionimi i njesive qe mbeshtesin Sistemet; d. Sigurimi i sherbimeve te komunikimeve elektronike dhe atyre me vlere te shtuar me ane te Sistemeve; e. Prodhimi dhe shfrytezimi i softwereve te lidhura me dhe per funksionimin e komunikimeve elektronike; f. Sigurimi, tregtimi dhe shperndarja e celulareve, te tjerave dhe pajisjeve, kompjuterave dhe aksesoreve te tyre, pajisjeve te komunikimeve elektronike, rrjete te transmetimit zanor, te pamjes dhe te dhenave dhe produkte te komunikimit dhe aksesore te lidhur me sherbimet e komikimeve elektronike; g. Sigurimi, tregtimi dhe shperndarja e materialeve promocionale qe mbajne logon e Vodafone, ose logon e Vodafone se bashku me logon e secilit prej partnereve te tij zyrtare; h. Sigurimi i sherbimeve te medias audio dhe/ose audiovizuale. i. Sigurimi i sherbimeve te mbeshtetjes se biznesit nepermjet aktiviteteve call center ose te tjera, sherbime te burimeve njerezore, etj; j. Fumizimi, tregtimi, instalimi dhe integrimi i produkteve/sistemeve te teknologjise me te fundit perfshire por pa u kufizuar ne: platformat loT, pajisjet inteligjente, sistemet software, zgjidhjet digjitale etj.Ne cfaredo forme te lejuar nga ligji. Ne menyre qe te perftohen objektet e mesiperme, Shoqeria mund te; a. Marre pjese ne nje forum te cfaredo shoqerie ose biznesi apo tjeter, te brendshme apo te jashtme, me te njejtin objekt, identik ose te ngjashem te cfaredo lloji korporate. b. Bashkepunoje ne cfaredo menyre me cdo lloj personi fizik ose juridik; c. Vendose zyra te degeve ose agjenci kudo Brenda vendit (ne Shqiperi) ose jashte; d. Perfaqesoje objektin e lidhur te shoqerive te aktivitetit qofshin te brendshme ose te jashtme.
13. Sistemi i administrimit	☒ me një nivel ☐ me dy nivele
14. Administratori/ët	Balázs Révész
14.1 Afati i emërimit	Nga: 01/05/2025 | Deri: 30/04/2027
15. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.	
15.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka).	

16. Anëtarët e Këshillit të Administrimit *(plotësohet nëse është Sh.a me një nivel)* 16.1 Kryetar/anëtar 16.2 Afati i emërimit	Arlind Kokona	
	Anetar	
	Nga: 05/07/2023	Deri: 04/07/2026
17. Anëtar i Pavarur 17.1 Përfaqësues i Punëmarrësve 17.2 Kushtet e pjesëmarrjes	Po	
	Jo	
18. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.		
19. Anëtarët e Këshillit të Administrimit *(plotësohet nëse është Sh.a me një nivel)* 19.1 Kryetar/anëtar 19.2 Afati i emërimit	Erald Hysa	
	Anetar	
	Nga: 23/10/2025	Deri: 23/10/2028
20. Anëtar i Pavarur 20.1 Përfaqësues i Punëmarrësve 20.2 Kushtet e pjesëmarrjes	Po	
	Jo	
21. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.		
22. Anëtarët e Këshillit të Administrimit *(plotësohet nëse është Sh.a me një nivel)* 22.1 Kryetar/anëtar 22.2 Afati i emërimit	Liam O'Brien	
	Anetar	
	Nga: 23/10/2025	Deri: 23/10/2028
23. Anëtar i Pavarur 23.1 Përfaqësues i Punëmarrësve 23.2 Kushtet e pjesëmarrjes	Po	
	Jo	
24. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.		
25. Anëtarët e Këshillit të Administrimit *(plotësohet nëse është Sh.a me një nivel)* 25.1 Kryetar/anëtar 25.2 Afati i emërimit	Balazs Revesz	
	Anetar	
	Nga: 05/07/2023	Deri: 04/07/2026
26. Anëtar i Pavarur 26.1 Përfaqësues i Punëmarrësve 26.2 Kushtet e pjesëmarrjes	Po	
	Jo	

27. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.		
28. Anëtarët e Këshillit të Administrimit *(plotësohet nëse është Sh.a me një nivel)*	Jonida Lakuriqi	
28.1 Kryetar/anëtar	Anetar	
28.2 Afati i emërimit	Nga: 23/10/2025	Deri: 23/10/2028
29. Anëtar i Pavarur	Po	
29.1 Përfaqësues i Punëmarrësve	Jo	
29.2 Kushtet e pjesëmarrjes		
30. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.		
31. Eksperti/ët Kontabël i Autorizuar	Dega ne Shqiperi e Shoqerise ERNST & YOUNG - EKSPERTE KONTABEL TE AUTORIZUAR	
31.1 Afati i emërimit	Nga: 03/12/2020	Deri:
32. Aksionarët	Vodafone Europe B.V.	
32.1 Numri i Aksioneve	Me te drejte vote: Pa te drejte vote:	
32.2 Përqindja e pjesëmarrjes	100,000	
33. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Durres Nikel RINAS Tirana International Airport "Nene Tereza". Tirane Tirane Bulevardi: "Deshmoret e Kombit", Qendra Piramida, Njesia BE 1, Zona Kadastrale 8160, Tirane Elbasan Elbasan Hotel Skampa, Ish- Turizmi, Nr. pasurie 1/66, Zona Kadastrale nr. 8521, Elbasan Korce Korçe Rruga: "Themistokli Germenji" , Pallati nr.3, Apt. 2, Zona Kadastrale 8561, Pasuria nr. 2/22, Volumi 19, Faqe 211, Korcë Tirane Farke LUNDER Rruga Nacionale "Tirane- Elbasan", Qendra Tregtare TEG, njesia A-058, niveli 0, Farke, Lunder, Tirane Tirane Tirane Rruga: "Muhamet Gjollesha" , Hyrja 0, Zona Kadastrale 8250, Tiranë Tirane Tirane Rr. "Reshit Collaku", Pallati "Aurora Construcsion", kati i 2-te, njesia Bashkiake nr. 10, Tirane 1001 Tirane Tirane Bulevardi: "Zogu I", Zona Kadastrale nr.8350,	

	Njësia Bashkiake nr. 9, Tiranë Tirane Tirane TIRANE Autostrada Tirane - Durres, Km.9, Rruga Egnatia, Tirana Industrial Park, Rruga e Rinasit Tirane Tirane TIRANE Rruga Ibrahim Rugova, Nr.42 Tirane Tirane TIRANE Magazina Vodafone- Autostrada Tirane-Durres Km 9 Vlore Vlore Lagja: "Lef Sallata", Rruga: "Sadik Zotaj", Blv. Vlorë-Skelë, Nr.373, Zona Kadastrale 8603, Nr. pasurie 26/97-N17, Vol.54, Fq.133, Vlorë Fier Fier Bulevardi: "Jakov Xoxa" , ish- Hotel Turizmi, Lagjja "Apollonia", Zona Kadastrale nr.8534, pasuria me numer 3147, volumi 16 faqe 183, Fier Tirane Tirane TIRANE AUTOSTRADA TR-DR - KM6-KASHAR Shkoder Shkoder Lagjja: "Vasil Shanto", Zona Kadastrale Nr. 8594, Nr. Pasurie 1/188, Shkodër Durres Durres Rr. "Tregtare", Lagjja Nr. 1, Zona Kadastrale Nr. 8512, me numër pasurie Nr. 24/166-NI, Durrës
34. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: VODAFONE ALBANIA E-Mail: silvana.daku@vodafone.com Telefon: +355696793072
35. Statusi:	Aktiv

Datë: 12/01/2026

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

DATE 24.08.2023

VENDNDODHJA

BASHKIA MALIQ FSHATI GURSHQIPE ZONA KADASTRALE 1911 NUMRI PASURISE 137 INDEX HARTE K-34-114-(209-D)

KOORRDINATAT WGS 84: 40°42'43.22"N 20°30'56.52"E KOORDINATAT KRRGJSH: X 543576.910 Y 4508719.100

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X 543280.00
Y 4508950.00

X 543770.00
Y 4508950.00



X 543280.00
Y 4508450.00

X 543770.00
Y 4508450.00

SH 1:2500

REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT

EMRI: ING. ARIAN SHTEMBARI

LICENCA: NR. N.6932/8 DATE 31.03.2022

KOMPANIA: A.SH. ENGINEERING sh.p.k

NIPT: L31617003F

NENSHKRIMI/VULA _____ Arian Shtembari

REALIZOI PER BASHKIA MALIQ

MIRATOI

PERGJEGJESI/DREJTORI_____

NENSHKRIMI / VULA _____

KONFIRMOI

KRYETARI BASHKISE_____

NENSHKRIMI / VULA _____





EKONOMIA PYJORE MOGLICE

VENDODHJA E SIPËRFAQES PËR NGRITJE ANTENE NGA VODAFONE SIPAS KORDINATAVE TË KËRKESËS.

2026

Coordinate System: WGS 1984 UTM Zone 34N

LEGJENDA

EP_Moglice

N

0 2,75 5,5 11 16,5 22 Km

0 1.5 3 6 9 12 Miles





EKONOMIA PYJORE
MOGLICE

VENDODHJA E SIPËRFAQES PËR NGRITJE ANTENE NGA VODAFONE SIPAS KORDINATAVE TË KËRKESËS.

2026

Coordinate System: WGS 1984 UTM Zone 34N

LEGJENDA

EP_Moglice

N

0 2.75 5.5 11 16.5 22 Km

0 1.5 3 6 9 12 Miles